



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbal i dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028 në sektorin e Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Data: 09.06.2025

Të dhënat e përgjithshme

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutit të Komunës së Podujevës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbal mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri më datë 20.06.2025, në emailin: info.podujeva@rks-gov.net

Procesverbal është një dokument publik i hartuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjin për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Hartuesi ka redaktuar të dhënat personale të palëve të mbledhura gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar kanë qasje në këto të dhëna, të cilat janë të arkivuara në komunë.

Dokumenti përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit, përmbledhjen e diskutimeve dhe në aneks materialet e bashkëngjitura të mbledhura gjatë takimit.

Veprimet para nisjes së takimit

Para nisjes së diskutimit, pjesëmarrësit janë regjistruar në listën përkatëse duke ofruar emrin, mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Këto të dhëna janë mbledhur për qëllime dokumentimi dhe dëshmimi të pjesëmarrjes në dëgjimet publike të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 (KAB).

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka pasur nevojë për përkthyes apo interpret për persona me aftësi të kufizuara.

Zhvillimet gjatë takimit

Takimi filloi në ora 18:15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal të Podujevës.

Të pranishëm ishin:

- ***Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani***
- ***Zyrtarja nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim***

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 18 persona: 15 burra dhe 3 gra.

(Shih në aneks: fotografitë dhe lista e pjesëmarrësve)

Fjalimi hyrës nga drejtori i Financave

Drejtori Fatlum Osmani hapi zyrtarisht dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028 me këtë mesazh:

“Të nderuar qytetarë, në emër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, hap zyrtarisht dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 për Komunën e Podujevës.

Ky dokument strategjik përcakton prioritetet financiare të komunës në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe objektivat zhvillimore. Ai përgatitet në harmoni me Qarkoren Buxhetore 2026/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, e cila përcakton udhëzimet dhe kufijtë fillestarë për hartimin e buxhetit.”

Limite buxhetore fillestare për vitin 2026 për Komunën e Podujevës:

- ***Granti i përgjithshëm: 14,627,269 €***
- ***Granti për arsim: 13,690,040 €***
- ***Granti për shëndetësi: 3,687,591 €***
- ***Shërbimet rezidenciale: 230,000 €***
- ***Financimi i teatrove: 185,729 €***
- ***Të hyrat vetanake: 2,358,325 €***

Totali i planifikuar: 34,778,954 €

Prioritetet e KAB-it Komunal përfshijnë:

- ***Ngritjen e cilësisë së arsimit dhe lidhjen me ekonominë***
- ***Zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe rurale***
- ***Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore***
- ***Zhvillimin ekonomik vendor dhe bujqësor***
- ***Barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale***
- ***Planifikimin shumëvjeçar të projekteve kapitale***

“Kjo Kornizë është përgatitur sipas strukturës së planit kontabël dhe në përputhje me kërkesat e buxhetimit të orientuar në performancë, duke përfshirë komponentët gjinorë dhe indikatorët e rezultateve në çdo program.

Të nderuar pjesëmarrës, ky dëgjim publik është një mundësi që secili prej jush të japë kontributin e vet për të ndikuar në përfaqësimin e drejtë të prioriteteve buxhetore. Vetëm përmes pjesëmarrjes suaj të drejtpërdrejtë mund të ndërtojmë një buxhet të drejtë dhe gjithëpërfshirës,” përfundoi drejtori Osmani.

Kërkesat nga pjesëmarrësit në dëgjim publik

Agim Hamza

- ***Rregullimi i oborrit/parkingut të shkollës “Enver Maloku”***
- ***Gëlqerosja e shkollës***
- ***Përfundimi i punimeve për sallën e edukatës fizike***

Adil Haliti

- ***Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Metehisë***
- ***Ndërtimi i trotuarit nga lagja Zuka deri te shkolla***
- ***Vendosja e pengesave vibruese në rrugën përballë shkollës (rruga e poshtme)***

Imer Hoti

- ***Vendosje e shenjave në afërsi të shkollës në Bradash***
- ***Ndërtimi i trotuarit në Bradash***

Fehmi Pollomi

- ***Renovimi i dyerve dhe dritareve të shkollës në aneksin e Surdullit***
- ***Ndërrimi i dyshemesë në shkollën “Rilindja” në Herticë***
- ***Rregullimi i rrugës për shkollën e Herticës***

Visar Duli

- ***Ndërrimi i dritareve***
- ***Furnizim me ujë***

Enver Halimi

- ***Ndërtimi i fushës sportive në shkollën e Pollatës***
- ***Ndërtimi i një pusi të ujit pranë shkollës***

Ismet

- ***Ndërtimi i rrethojave të shkollës në Llaushë***
- ***Investime në shkollë për shkak të gjendjes së saj jo të mirë***

Fatmir Emini

- ***Kërkesë për kabinete shkollore***
- ***Renovime dhe ndërtimi i një aneksi të shkollës***
- ***Rregullimi i parkingut dhe gypave të ujit***
- ***Gëlqerosja e shkollës***

Mbyllja e takimit

Takimi përfundoi në ora 19:30.

Në këtë dëgjim publik morën pjesë 18 persona, me gjithsej 21 kërkesa të regjistruara.

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve sipas gjinisë

Gra	3
Burra	15
Totali	18

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028
Sektorët: Arsim, shëndetësi, kulturë, rini dhe sport

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	AGIM HAMTA	PODUJEVE	
2.	VISAR DULI	KERPIMEH	
3.	Enver Halimi	Podujevë	
4.	Enver Halimi	Podujevë	
5.	Behar Kollari	Herzice	
6.	Enver Mehmed	Podujevë	
7.	Lulzim Ajvazi	Spasol	
8.	Ghaip Mehani	Podujevë	
9.	Ismael Durrugji	Marac	
10.	ZITA RASHTIKU	KFOR	
11.	ASDREN LLIGORIN	KFOR	
12.	UDHMET JASHARI	PODUJEVE	
13.	Shehida Halilaj	Podujevë - Podujevë	
14.	Elza Salihu	Podujevë	
15.	Adil Haliti	Metku	
16.	Khendet Zhugolli	Siboc / epërm	
17.	FATMIR EMIRI	PERAN	
18.	IMER HOTI	BRADASH	
19.			
20.			
21.			
22.			

Podujevë: 09.06.2025

